Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK

ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

# TESTI
# HISTORI

**1.** Lojërat e para moderne Olimpike janë mbajtur në Athinë në vitin 1896.

Cilës dekadë dhe cilit shekull i takon ky vit?

Përgjigja: _______________ dekada _________________ shekulli.

**2.** Në cilën periudhë historike është mbajtur Kongresi i Berlinit (viti 1878)?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Koha e Vjetër

○ Koha e Mesme

○ Koha e Re

○ Koha Bashkëkohore

**3.** Çfarë nënkuptohet me konceptin manifaktura?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ lloji i ekonomisë natyrore

○ forma e prodhimit me dorë

○ formën primare të veprimtarisë bankare

○ Makinat me avull

**4.** Si quhet shteti me të cilin kanë sunduar Stefan Llazareviqi dhe pasardhësit e tij?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Perandoria serbe

○ Mbretëria serbe

○ Despotati serb

○ Dukata serbe

**5.** Gjatë kohës së cilit sundimtar Serbia përsëri është bërë mbretëri?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ gjatë kohës së Mihail Obrenoviqit

○ gjatë kohës së Petar Karagorgjeviqit të Parë

○ gjatë kohës së Milan Obrenoviqit

○ gjatë kohës së Petar Karagjorgjeviqit të Dytë

**6.** Si quhet procesi i zhvendosjes së popujve i cili ka filluar me depërtimin e Hunëve në Evropë në fund të shekullit IV?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Zbulimet e mëdha gjeografike

○ Dyndja e madhe e popujve

○ Krishterimi

○ Gjermanizimi

**7.** Në territorin e cilit shtet Gavrilo Principi ka kryer atentatin mbi trashëgimtarin e fronit Franc Ferdinandit me ç`rast edhe ka filluar Lufta e Parë Botërore?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ E Mbretërisë Serbe;

○ E Monarkisë Austro – Hungareze;

○ e Perandorisë Osmane;

○ e Mbretërisë së Malit tëZi

**8.** Çfarë ka qenë pasojë e dhunës së dahijëve në Pashallëkun e Beogradit mbi popullsinë serbe?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Lufta e Vjenës

○ Aneksimi i Bosnjës dhe Hercegovinës

○ fillimi i kryengritjes së parë serbe

○ Lufta e Parë Botërore

**9.** Ngjyros rrethin përpara burimit historik i cili flet për shpalljen e luftës ndaj Mbretërisë së Serbisë nga këndvështrimi i Austro-Hungarisë.

○ „Qeveria mbretërore e Serbisë nuk iu përgjigj në mënyrë të kënaqshme në notën e datës 23 korrik 1914.të cilën ia dorëzoi i dërguari i austrohungarisë në Beograd. Për atë qeveria mbretërore konsideron se është e detyruar që të përcaktohet në forcën e armës me qëllim të ruajtjes së interesit dhe të drejtave të veta. Austrohungaria konsideron se nga ky moment ndodhet në luftë me Serbinë."

○ „Serbia u sulmua nga një e keqe e madhe. Austrohungaria na shpalli luftë. Pakënaqësitë e mbretërisë sonë dhe të popullit tonë me Austrohungarinë nuk kanë filluar që dje (...) Unë jam i detyruar të i thërras të gjithë trimat serbë nën trengjyrëshin serb (...) Serb, mbrojeni, me forcën vatrën dhe fisin tuaj!"

**10.** Ngjyrosni rrethin në fushën e duhur në mënyrë që të lidhni ngjarjet nga historia serbe me ngjarjet nga historia e përgjithshme që ndodhën në të njëjtën kohë.

| | **Lufta e Vjenës** | **Luftërat e Napoleonit** | **Kongresi i Berlinit** |
|---|---|---|---|
| Fillimi i Kryengritjes së Parë Serbe | ○ | ○ | ○ |
| Fillimi i Kryengritjes së Dytë Serbe | ○ | ○ | ○ |
| Dyndja e Parë e Madhe e Serbëve | ○ | ○ | ○ |
| Dyndja e Dytë e Madhe e Serbëve | ○ | ○ | ○ |

**11.** Ngjyros rrethin në fushën e duhur në mënyrë që të shënoni ngjarjet nga historia serbe me ngjarjet nga historia e përgjithshme që kanë lidhje të drejtpërdrejtë.

| | **fillimi i Luftës së Parë Botërore** | **Revolucioni xhonturk** | **përfundimi i Luftës së Parë Botërore** |
|---|---|---|---|
| kriza aneksioniste | ○ | ○ | ○ |
| Atentati i Sarajevës | ○ | ○ | ○ |
| Shpërthimi i Frontit të Selanikut | ○ | ○ | ○ |
| Përmbysja e Majit | ○ | ○ | ○ |

**12.** Në çfarë mënyre ka ndikuar rezultati i Kryqëzatës së IV në ndryshimet e shtetit mesjetar serb të Nemanjiqëve.

○ shteti serb ka arritur statusin e mbretërisë
○ Stefan Nemanja pavarësohet në raport me Bizantin
○ Stefan Nemanjiqi ka trashëguar të atin e vet në fron
○ vëllezërit Stefani, Vukani dhe Rastko ka ndarë pushtetin në shtet

**13.** Cila prej institucioneve të paraqitura është formuar në periudhën e mesjetës, ndërsa ekziston edhe sot.

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Akademia serbe e shkencës dhe artit
○ Kisha ortodokse serbe
○ Universiteti në Beograd
○ Biblioteka Popullore

**14.** Vandalët pushtuan dhe shkretuan Romën në vitin 455. Në kujtim të asaj ngjarje u krijua edhe shprehja vandalizëm. Çka paraqet ai sot?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ shkatërrimi i pronës publike dhe përmendoreve të kulturës;

○ besimin në superioritetin e popullit të vet;

○ urrejtjen dhe mos durimin ndaj armikut;

○ shkeljen e të drejtave njerëzore.

**15.** Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.
Administrata e Dahive në Pashallëkun e Beogradit solli te shpërthimi i Kryengritjes së Parë serbe për shkak të:

○ dëshirës së sulltanit që drejtpërdrejt të administroj me Beogradin;

○ heqjen e Patrikanës së Pejës;

○ zbatimin e dhunës mbi popullsinë serbe;

○ futjes së tatimit në gjak.

**16.** Ngjyros rrethin përpara atij burimi historik i cili përshkruan betejën e Maricës nga këndvështrimi i Turqve osmanë.

○ „Ajo ndodhi pranë lumit Marica. Numri më i madh i jobesimtarëve u rrëzuan në lumë. U mbytën. Nga ata jobesimtarë pak shpëtuan. Që rrezikon se të gjithë u vranë. Disa i zunë rrugës dhe i shkatërruan. Tani atë vend e quajnë Vdekja e serbëve. Kur jobesimtarët me ndihmën e Zotit u thyen, shkuan."

○ „Despoti Ugljesha i ngriti të gjithë ushtarët serb dhe grek, dhe vëllaun e vet Vukashin kralin, dhe shumë zotëri të tjerë, (...) dhe shkuan në Maqedoni për të dëbuar Turqit, (...) dhe nuk i dëbuan, veç së vet u vranë nga ata dhe atje kockat e tyre mbetën, dhe të pavarrosur mbetën, dhe (...) disa nga tehu i shpatës vdiqën, kurse të tjerët në robëri i çuan."

**17.** Lexo me vëmendje fragmentin, nga burimi historik, dhe shkruaj vitin kur ka ndodhur ngjarja e përshkruar në burim.

„Milloshi, në Agun e mëngjesit erdhi në Takovo, dhe po atë ditë te kisha e bëri kuvendin. Filloi publikisht të përgatitet me popullin dhe fisnikët dhe të vendosin se çfarë do të bëjnë tani. I tërë kuvendi vendosi se ndryshe nuk munden, por vetëm të luftojnë me Turqit deri sa të vdesin të gjithë; / ... /prandaj u veshën në veshjet e tyre prej vojvode dhe mbërthyen armët e argjendta, e ashtu të veshur bukur dolën para djemve duke bartur në duar flamurin e vet të vojvodëve , i cili deri tani kishte qëndruar i fshehur diku, ia ofroi flamurin Sima Pashtërmcit duke folur: "Ja ku jam dhe këtu e keni luftën me turqit" ...

Përgjigja: _____________

**18.** Në cilin vit është zhvilluar beteja te Vaterlo, me të cilën përfundoi sundimi i Napoleon Bonapartës?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ në vitin 1810 ○ në vitin 1812 ○ në vitin 1815 ○ në vitin 1817

**19.** Përse termi i të drejtave të njeriut lidhet me trashëgiminë e Revolucionit Francez?

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

○ Me heqjen e monarkisë dhe shpalljen e Francës Republikë është hequr robëria.

○ Të drejtat themelore të njeriut për herë të parë janë krijuar me Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit.

○ Me heqjen e marrëdhënieve feudale dhe vendosjen e marrëdhënieve kapitaliste qytetarët fituan të drejtën në gjatë revolucionit të Francës.

○ Për shkak të mënyrës në të cilin gjat revolucionit të Francës veprohej me qytetarët dhe kundërshtarët e revolucionit.

**20.** Lexo fragmentin nga burimi dhe përgjigju në pyetjen.

„...Ky perandori Dushan u kurorëzua për perandor dhe zgjodhi për veten patriarkun serb jo sipas ligjit dhe as me uratën e patriarkut të Kostandinopojës, ashtu si i ka hije ... U kap ai në kurth nga armiku i përgjithshëm, u drejtua me zemër... la nga stërgjyshërve dh Shën Sava iu dorëzua arqipeshkvisë …e vendosi për veten me dhunë patriarkun Joanik. Pastaj me këshillën e këtij i largoi mitropolitët të cilët ishin nëpër qytetet e territoreve të tij...“

Vazhduesi i Danilos

Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

Autori i burimit shprehu qëndrimin e tij negativ ndaj perandorit Dushan për shkak të:

○ thyerjes së rregullimit shtetëror dhe kishtar dhe zakoneve;

○ humbjes nga armikut;

○ varfërisë në shtet;

○ grindjes në mes perandorit Dushan dhe patriarkut Joanik.